

VENDIM
Nr. 625, datë 24.9.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR - HANI I HOTIT (OBJEKTE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër - Hani i Hotit (objekte).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me vlerë të përgjithshme 9 162 713 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 162 713 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri "Detyrimet e prapambetura, (detyrimet e infrastrukturës)".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi "Proces regjistrimi, kufizuar", të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë plotësuar dokumentacionin e plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORISË PROJEKTEVE TË HUAJA
TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMIT

Lista emërore e pronarëve që shpronësohen për objektet që preken nga ndërtimi i rrugës
 “Shkodër-Hani Hotit”

Nr.	Pronari			Numri rendor sipas listave të publikimit	Z.K.	Nr. Pas.	Emërtimi i objektit	Vlefte (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Xhabir	Zyber	Mehmeti	52 lista nr.2	3429	101/4	Karburant	684484	Proces regjistrimi
2	Ilir	Ali	Rama (Muja)	20 lista nr.1	1495	153/26	Dyqan	2556047	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Avni	Rrustem	Aliaj	3 lista nr.1	1495	28/27	Dyqan	3520532	Kufizuar
4	Niko	Mark	Nika	30 lista nr.1	1495	28/30	Dyqan	2401650	Konfirmuar nga ZVRPP
	Shuma							9162713	